

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:”SISTEMIM I RRUGEVE TE BRENDSHME NARAÇ ”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):45000000-7 , pune ndertimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 23 403 987** (njëzet e tre milion e katërqind e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

---

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*”, ”*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: *b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën

vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet konkretisht: **11.701.994** (njemdhjetë milion e shtatëqind e një mijë e nentëqind e nentëdhjetë e kater) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **46.807.974** (dyzet e gjashtë milion e tetëqind e shtatë mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e kater) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

**Vlerësimi i përvojës së sukseshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;**(nese leshohet)**
  - Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;**(nese leshohet)**
  - Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
  - Fatura tatimore perkatese.

*Argumentimi:* Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **11.701.994** (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e një mijë e nentëqind e nentëdhjetë e kater) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
  
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **46.807.974** (dyzet e gjashtë milion e tetëqind e shtatë mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e kater) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e*

*pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Neni 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

**Punime të përgjithshme ndërtimi:**

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjellesa ,gazsjellesa,vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje”

**Punime speciale ndërtimi:**

Kategoria NS-6 Niveli A “Punime për sinjalistiken”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerrat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Germim dheu me ekskavator zingjir, 1.0 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	Niveli A	404 196



<u>Kategoria</u> NP-4	Rruge ,autostrada,mbikalime	Kapitulli B. I preventivit	Niveli B	21 747 300
<u>Kategoria</u> NP-7	Ujesjellesa ,gazsjellesa,vajsjellesa	Kapitulli D I preventivit – Punime per kanalet	Niveli A	9,800
<u>Kategoria</u> NS-6	Punime per sinjalistiken	Vizime me boje bikomponente (shirit 12cm ne 2 anet e rruges)	Niveli A	692 160
<u>Kategoria</u> NS-18	Punime topogjeodezike		Niveli A	

**Shenim:** Pika e licences për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësim të gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në cdo fazë të zbatimit të punimeve.

**2.3.3** Vetdeklarimin nga inxhinierat se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 datë 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Për kryerjen e punimeve numri minimal i punonjësve duhet të jetë **13 (trembëdhjetë), nga të cilët minimalisht 7 (shtate) punonjës duhet të figurojnë në listëpagesat e të paktën 3 muajve të fundit.**

**a) 1 (nje) inxhinier ndërtimi - drejtues teknik**

*Inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë i pajisur licence profesionale individuale “Inxhinier Ndërtimi” sipas lidhjes 2 të VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit dhe projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, kontrate pune të vlefshme.*

**b) 1 (nje) inxhinier ndërtimi**

*Inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë i pajisur licence profesionale individuale “Inxhinier Ndërtimi” sipas lidhjes 2 të VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit dhe projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, kontrate pune të vlefshme.*

***Inxhinieri i ndërtimit duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se nuk do të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës që prokurohet.***

- ***Në rast se inxhinieri i kërkuar në pikën 2.3.4 germa a, nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe është i disponueshëm në kantier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të***

**kontratës, gjë të cilën ai do ta vërtetojë me paraqitjen e deklaratës, atëherë pika 2.3.4 germa b nuk është e detyrueshme të plotësohet.**

**c) 1 (nje) inxhinier topograf**

*Inxhinieri topograf duhet te jete i pajisur licence profesionale individuale "Inxhinier Gjeodet"/"Inxhinier Markshajder" sipas lidhjes 2 te VKM nr. 759, date 12.11.2014 "Per licencimin profesional te individeve dhe subjekteve juridike qe do te ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit dhe projektimit ne ndertim dhe mbikqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim", i ndryshuar të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, kontrate pune te vlefshme.*

*Inxhinieri topograf duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.*

**d) 1 (nje) teknik ndertimi**

*Tekniku i ndërtimit duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional / arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH",kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libreze pune, dhe të figurojë në listëpagesa të paktën 3 muajt e fundit.*

**e) 3 (tre) Manovratorë**

*Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjesëse dhe të asfaltimit) duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. **(Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).***

**f) 3 (tre) Manovratorë**

*Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjesëse dhe të asfaltimit) duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. **(Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).***

**g) 1 (nje) punëtor asfalti**

*Punëtori asfaltit duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional / arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH",kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit*

teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libere pune, dhe të figurojë në listëpagesa të paktën 3 muajt e fundit.

**h) 1 (një) Betonues**

**i) 1 (një) Hekurkthyes**

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listëpagesen perkatëse E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

Eshtë kërkuar inxhinier ndertimi për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit, projektit, specifikimeve teknike qe do te zbatohen dhe si dhe kategorive perkatëse ne licencen perkatëse te zbatimit. Inxhinieri ndertimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve qe vendosen ne objekt . Janë kërkuar inxh. Ndërtimi drejtues teknik dhe inxhinier ndërtimi, në mënyrë që të mos penalizohen OE që drejtuesit teknikë i kanë të angazhuara në kontrata të tjera. Inxhinieri i ndërtimit është kërkuar që të jetë inxhinier i kantierit, nën mbikqyrjen dhe udhëzimet e drejtuesit teknik. Është kerkuar inxhinier topograf per kryerjen e punimeve topografike per nxjerrjen e kuotave te punimeve te germimit si dhe kuotat e shtresave rrugore, sistemimin e kanaleve anësore etj.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketyre kriterëve per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perllogaritur si dhe mjeteve te kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Kerkesa qe punonjesit te jene me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë eshte bere bazuar duke

vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet te paraqesin deshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme.

Kerkesa për deshmite e drejtuesve të mjeteve të rënda bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

**7114 Betonues:** Kodi i profesionit: 7114 Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Betonues dhe të tjerë që lidhen me to”, niveli i dytë i kompetencës në LKP. Betonuesi dhe të tjerë që lidhet me to ndërton korniza dhe struktura të përforcuara prej betoni ose prej allçie, përforcojnë sipërfaqet e çimentos, bën vendosjen e çimentos në mure, korniza shkallësh, tarraca, etj. Gjithashtu, ai përfundon dhe riparon sipërfaqe prej çimentoje. Ndërton struktura të përforcuara hekuri për vëllimet apo sipërfaqet që do të betononjë sipas një projekti paraprak. Ai mund të punësohet në kompani të ndryshme me aktivitet ndërtimi apo të vetëpunësohet. Funksionet kryesore: Betonuesit dhe të tjerë që lidhet me to kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: “a) Njihen me projektin dhe specifikimet teknike të objektit ku do të punojnë; b) Bëjnë kontrollin paraprak të vendit të punës para fillimit të procesit; c) Bëjnë organizimin e punës me kolegët e tjerë përpara fillimit të procesit; d) Bëjnë sistemimin e materialeve dhe veglave të punës sipas proceseve të punës. e) Respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt; f) Sigurojnë sasinë e duhura të materialeve për betonin (hekur, dërrasa, skela, zhavorr, çimento, rërë, ujë etj.), sipas markave të përcaktuara në projekt; g) Realizojnë – në bashkëpunim me punëtorët e tjerë – ndërtimin e skelës që do shërbejë si plan pune për zhvillimin e operacionit; h) Ndhmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosjen e kallëpeve apo formave të ndryshme sipas projekteve paraprake; i) Vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton; j) Ndhmojnë në vendosjen e hekurit të duhur dhe lidhjen e tij; në sasinë dhe formën e përcaktuar në projektin inxhinierik; k) Realizojnë procesin e

*përzierjes së sasisë së duhur dhe raportet e paracaktuara të materialeve përbërëse të betonit me sasinë e duhur të ujit, me dorë ose me makineri; l) Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit; m) Bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi; n) Kryejnë nivelimin e betonit;13 o) Kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos; p) Bëjnë trajtimin me ujë të strukturave pas betonimit; q) Bëjnë riparimin e defekteve të vogla pas betonimeve (zgavra, vrima etj.); r) Bëjnë dorëzimin e punimeve tek drejtuesi teknik i objektit duke bërë dhe shënimet përkatëse të afateve të punimit të kryer; s) Bëjnë riparime të ndryshme të sipërfaqeve të betonuara; t) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. u) Bëjnë preventiv për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit”*

**Hekurkthyes:** *a. Përzgjedhin llojin e hekurit sipas specifikimeve të bëra në projekt; b. Bëjnë matjet e duhura të hekurit duke respektuar tolerancat teknike; c. Presin hekurin sipas përmasave të duhura duke eliminuar mbetjet (sa më pak firo); d. Bëjnë kthimin e hekurit sipas formave të përcaktuara në projekt; e. Vendosin hekurin sipas specifikimeve të projektit; f. Bëjnë “mbjelljen” e kolonave në bashkëpunim me topografin ose inxhinierin e zbatimit për strukturat vertikale (kolona, mure anësore etj.); g. Bëjnë montimin (lidhjen) e hekurit sipas specifikimeve të përcaktuara; h. Për strukturat horizontale (trarë, soleta etj.) puna fillon me lidhjen e trarëve duke respektuar distancat e vendosjes së personelave sipas projektit; i. Bëjnë lidhjen e hekurave të soletës (që mund të jetë monolite ose e lehtësuar); j. Kontrollon strukturat e përfunduara të hekurit që të jenë në përputhje me projektin; k. Bëjnë dorëzimin e punimeve tek drejtuesi teknik i objektit; l. Kryejnë detyra të lidhura me mbikëqyrjen e punëtorëve të tjerë; m. Bëjnë preventiv për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit; n. Përdorin veglat, mjetet apo makineritë e duhura të punës si; gërshërë hekuri dore, gurë fresibël, makinë prerëse (tranzhë), banko kthimi hekuri sipas trashësisë së hekurit, banko personelash etj. o. Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.*

**7119.15 Punëtor asfaltimi në rrugë** (Grup njësi - Punëtorë ndërtimi të paklasifikuar diku tjetër) y) Kryejnë asfaltime apo punime mirëmbajtje në rrugë;

**Kërkesat për punësim:** *a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion. b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.*

**3119.15 Teknik ndërtimi** (Grup njësi “Teknikë të shkencës së fizikë dhe inxhinierisë të pa klasifikuar diku tjetër” Kodi i profesionit: 3119) **Funksionet kryesore:** *Teknikët e këtij grupi kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Mbledhin të dhëna dhe japin mbështetje teknike për të kontribuar në përdorimin sa më efikas, të sigurtë dhe ekonomik të burimeve njerëzore dhe materiale, por edhe të pajisjeve. b) Kontribuojnë me anë të komenteve dhe sugjerimeve për vendosjen dhe planimetrinë e linjës së punës duke pasur parasysh procesin e caktuar që zhvillohet. c) Zbatojnë metoda pune dhe një seri veprimesh për të kryer detyrat e caktuara. d) Mbikëqyrin ecurinë dhe vazhdimësinë e metodave dhe planeve të punës së përcaktuar. e) Ndihmojnë në identifikimin e kërcënimeve për sigurinë dhe prezantojnë procedurat*

dhe pajisjet e sigurisë tek punonjësit e tjerë. f) Manovrojnë pajisje të ndryshme që prodhojnë produkte dhe nënprodukte të produkteve të para. g) Montojnë pajisjet dhe materialet sipas procedurës së përcaktuar për të prodhuar produktin final. h) Kryejnë teste laboratorike dhe shënojnë rezultatet në regjistrat përkatës. i) Përgatisin preventivë të detajuar të sasive dhe kostove të materialeve dhe punës së nevojshme për kryerjen e punës me saktësi dhe efikasitet. j) Monitorojnë aspektet teknike, rregullatore dhe ato të sigurisë së ndërtimit, instalimit, manovrimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të materialeve dhe pajisjeve. k) Ndihmojnë në dizenjimin dhe planifikimin e materialeve, metodave dhe planeve të punës. l) Respektojnë politikat e brendshme të punës dhe procedurat e hartuara nga Institucioni. m) Zbatojnë kodin e etikës të miratuar nga drejtuesit. n) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit. o) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. **Kërkesat për punësim:** a. Zakonisht kërkohet të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale; në disa raste një diplomë nga një shkollë e mesme e përgjithshme dhe eksperiencë pune disa vjeçare është gjithashtu e vlefshme.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur për cdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve si më poshtë:

**Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjeshëse dhe të asfaltimit) dhe shoferat e kamionit (Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve” Kodi i profesionit: 8332)**

8332.03 Drejtues të makinave të asfaltimit

8332.06 Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)

8332.14 Shofer kamioni

**Kërkesat për punësim** a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit përkatës. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Nr. Analize	E M E R T I M I	Njesia	Punetori	Transport	Makineri	Material	Dite nga op e mak	Dite pune grafiku	Cope mak	Dite nga op e punetoreve	Dite pune grafiku	Nr. Punetore	Lloji I punetorit
			op	T/km	o.p	Sasia							
1	2	3	4	7	10	13	a = 10/8	c	b = a/c	d	e	f=d/e	g
3.107/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 1.0 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m3	1855										
	Ekskavator 1 m3	op			61.22		7.651875	4	2	7.651875	4	2	2 Drejtues ekskavatori/fadrome
An.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	155										
	Sp + p	op	52.7							6.5875	10	0.65875	
	Cakell e gur gurore	m3		2554.40		159.65					15		
	Ekskavator	op			12.4		1.55	10	0.155				1 drejtues ekskavatori/fadrome
	Rul me vibrim	op			6.2		0.775	10	0.0775				1 drejtues te makinave te ngjeshjes
	Autobot uji	op			3.1		0.3875	10	0.03875				
An.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	800										
	Sp + p	op	272							34	34	1	
	Cakell e gur gurore	m3		13,184		824							
	Ekskavator	op			64		8	8	1			1	1 drejtues ekskavatori/fadrome
	Rul me vibrim	op			32		4	4	1				1 drejtues te makinave te ngjeshjes
	Autobot uji	op			16		2	2	1				

<b>3.212/b</b>	<b>Shtrese stabilizant t=10cm</b>	<b>m2</b>	<b>9000</b>										
	Sp + p	op	675										
	Grejder	op			135.000		16.875	16.875	1			1	1 drejtues eskavatori/fadrome
	Rul me vibrim	op			360.00		45	45	1				1 drejtues te makinave te ngjeshjes
	Autobot	op			162.00		20.25	20.25	1				
	Stabilizant	m3		21,060		1170							
<b>3.212/a</b>	<b>Shtrese stabilizanti t=5cm</b>	<b>m2</b>	<b>1000</b>										
	Sp + p	op	50							6.25	3.125	2	
	Grejder	op			12.500								1 drejtues eskavatori/fadrome
	Rul me vibrim	op			30.00		3.75	3.75	1				1 drejtues te makinave te ngjeshjes
	Autobot	op			15.00		1.875	1.875	1				
	Stabilizant	m3		1170		65	0	0	1				
<b>3.228/1</b>	<b>Shtrese binderi me zall lavatrice,4cm,me makineri</b>	<b>m2</b>	<b>7750</b>										
	Sp + p	op	759.5							94.9375	40	2.373438	1 punetor asfalti
	Rul me kompresor	op			69.75		8.71875	8.71875	1				1 drejtues te makinave te ngjeshjes
	Autobitumatriçe	op			7.750		0.96875	0.96875	1				
	Asfaltoshtruese	op			69.75		8.71875	8.71875	1				
	Binder	ton		13640		682							
	Bitum	kg				3875							
<b>3.224/1</b>	<b>Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri</b>	<b>m2</b>	<b>7750</b>										
	Sp + p	op	635.5							79.4375	26.47917	3	1 punetor asfalti
	Rul me kompresor	op			54.25		6.78125	6.78125	1				1 drejtues te makinave te ngjeshjes
	Autobitumatriçe	op			7.750		0.96875	0.96875	1				
	Asfaltoshtruese	op			54.25		6.78125	6.78125	1				
	Asfaltobeton	ton		10695		534.75							
	Bitum	kg				3875							



<b>An151</b>	<b>Vizime me boje bikomponente (shirit 12cm ne 2 anet e rrules)</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>480</b>										
	Sp + p	op	240							30	15	2	2 punetore te thjeshte
	Sperkates boje	op			240		30	15	2				
	Boje bikomponente	kg				336							
	Te ndryshme 2 %	leke				#REF!							
<b>3.87/a</b>	<b>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke</b>	<b>m<sup>3</sup></b>	<b>368</b>										
	Ekskavator 0.25 m3	op			34.59		4.324	2.162	2				1 drejtues eskavatori
<b>3.363</b>	<b>Tombino me tuba betoni Ø 400, mbi shtrese betoni</b>	<b>ml</b>	<b>27.3</b>										
	Sp + p	op	68.25							8.53125	4.265625	2	1 punetor I paklasifikuar, 1 hidraulik
	Tub betoni Ø 400 mm	m				1.01							
	Zhavorr natyror me makine	m3				0.07							
	Rere e lare	m3				0.03							
	Zall i lare	m3				0.05							
	Çimento 32.5 N	kg				13.3							
	Kallep inventari	m2				0.4							
<b>3.243/1</b>	<b>Struktura monolite betoni C 16/20 (per veshjen e kanaleve dhe per mbulim tombino)</b>	<b>m<sup>3</sup></b>	<b>2.87</b>										
	Sp + p	op	36.736							4.592	4.592	1	1 betonues
	Betonjere 500 liter	op			1.87		0.233188	0.233188	1				
	Vibrator thellesie	op			4.71		0.58835	0.58835	1				
	Çimento 32.5 N	kg				290							
	Zall i lare lavatrice	m3				0.75							
	Rere e lare	m3				0.47							
	Uje	liter				200							
	Kallepe	m2				5.4							
<b>3.287</b>	<b>F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm</b>	<b>ton</b>	<b>0.04</b>										
	Sp + p	op	2.44							0.305	1	0.305	Hekurkthyes
	Vinç kulle 0.5 ~ 1 ton	op			0.03								
	Hekur betoni i zak Ø6~10mm	ton				1.01							

Tel bari	kg			6						
----------	----	--	--	---	--	--	--	--	--	--

Totali I materialeve qe do te transportohen	23 520	ton
Afati I punimeve	168	dite
Sasia e transportuar ne dite	140	ton/dite
Rruge kamioni ne dite	5	rruge
Sasia e transportuar per 1 rruge	28	ton
Kamionat qe nevojiten per transportin e 140 ton ne dite	1 kamione $\geq$ 18 ton, 1 kamion $\geq$ 10 ton	
Transporti i hekurit, betonit, tubave te betonit	1 kamioncine 3.5 ton	

**2.4** Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

<b>Nr</b>	<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>	
1	Mjet transporti veteshkarkues $\geq$ 18 ton (kapac.mбайtes)	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	Mjet transporti veteshkarkues $\geq$ 10 ton (kapac.mбайtes)	1 cope	Në pronësi ose me qera
3	Mjet transporti veteshkarkues 3.5 ton (kapac.mбайtes)	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator / fadromë	2 copë	Në pronësi ose me qera
5	Betoniere	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera
7	Autobot uji	1 cope	Në pronësi ose me qera
8	Rrul me vibrim per ngjeshje çakelli	1 cope	Në pronësi ose me qera
9	Rrul kompresor per ngjeshje asfalti	1 cope	Në pronësi ose me qera
10	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
11	Asfaltoshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera
12	Makineri Vijëzimi	2 copë	Në pronësi ose me qera
13	Kokore	12 copë	Në pronësi ose me qera
14	Jeleke	12 copë	Në pronësi ose me qera
15	Tabela sinjalizuese rrugore	3 copë	Në pronësi ose me qera
16	Kuti ndihme e shpejtë	1 copë	Në pronësi ose me qera

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne regjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- v. Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar.*

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, të paraqitura më sipër.

**2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte**

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kupërcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**2.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 168 dite kalendarike.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

**2.7** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat profesionale të mëposhtme:

Licencë nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë mbështetet në faktin

*që sipas punimeve të parashikuara në preventiv do të kemi punime gjurmimi në sasi të konsiderueshme.*

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*